



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministurtvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, 2019

Nr. 454-664

Në mbështetje të nenit 10 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, Prishtinë), duke u bazuar në Rregulloren Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Ligjin NR.06/L-133 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, lidhet kjo:

MARRËVESHJE E MIRËKUPITIMIT PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT
"NDËRTIMI I PARQEVE NË KOMUNË" KOMUNA SUHAREKË

Palët Nënshkruese

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e përfaqësuar nga Ministri i MAPL-së (në tekstin e mëtejme **MAPL**),
dhe,
2. Komuna e Suharekës përfaqësuar nga Kryetari Komunës, (në tekstin e mëtejme **Komuna**).

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është bashkëfinancimi i projektit "Ndërtimi i parqeve në komunë", si dhe përcaktimi i obligimeve të MAPL-së dhe Komunës së Suharekës , për realizimin e këtij projekti.

Neni 2

Vlera e projektit dhe mënyra e bashkëfinancimit

1. Projekti ka vlerën para llogaritave prej 70,000.00 €.
2. MAPL nga buxheti i saj vjetor i vitit 2019, financon këtë projekt në shumën prej 50,000.00 €.
3. Komuna e Suharekës nga buxheti i saj vjetor i vitit 2018, financon këtë projekt në shumën prej 20,000.00 €,

Neni 3

Obligimet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

1. MAPL-ja i zotën mjetet për projektin nga neni 2 paragrafi 2. i kësaj Marrëveshje dhe një kopje e dërgon në Komunë.
2. Pagesat nga MAPL, për vlerën e financimit do të bëhen në bazë të realizimit të punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës.
3. MAPL monitoron këtë projekt, dhe në rast se vëren parregullsi apo defekte gjatë realizimit të kontratës njofton menaxhmentin e MAPL-së.

Neni 4

Obligimet e Komunës

1. Komuna është e obliguar që pas nënshkrimit dhe protokollimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit, brenda dhjetë(10) dite të hartoj projektin zbatues, të siguroj tërë dokumentacionin e nevojshëm në mënyrë që të krijohen kushtet e nevojshme që projekti të realizohet pa pengesa, me qëllim që MAPL të fillon me procedurat e sigurimit të zotimit të mjeteve të dala nga kjo marrëveshje.
2. Palët janë pajtuar që Komuna të jetë bartëse e të gjitha procedurave të prokurimit.
3. Komuna e siguron deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve në vlerën e paralogaritur të projektit.
4. Komuna obligohet që projektin ta zhvilloj në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, si dhe aktet tjera nënligjore.
5. Komuna obligohet që pas nënshkrimit të kontratës me Operatorin Ekonomik të sjellë një kopje të kontratës identike me origjinalin në MAPL, së bashku me informatat për biznesin me qëllim të nxjerrjes së urdhër blerjes (numrin e biznesit dhe numri i llogarisë bankare).

6. Komuna e cakton: projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për mbikëqyrjen e kryerjes së punimeve dhe komisionin i cili lëshon certifikatën e pranimit të punimeve/pranimin teknik.
7. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë, vërteton sasinë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera, në bazë të cilave operatori ekonomike lëshon dokumentin financiar (faturën), me kërkesën për realizimin e pagesës të punimeve/furnizimeve të kryera, duke iu referuar kushteve të kontratës.
8. Komuna obligohet që të njoftoj MAPL-në për çdo propozim ndryshim eventuale të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit ndërsa për punime shtesë Komuna duhet të marrë aprovim paraprakisht nga MAPL (për pjesën e financuar nga MAPL).
9. Komuna e obligon Operatorin Ekonomik që të vendos tabelën informuese (Panon) standarde me shënimet për projektin, investitorët dhe operatorin ekonomik.
10. Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që projekti të përfundojë brenda vitit buxhetor 2019. Pas këtij afati të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë i kalojnë Komunës.
11. Komuna është e obliguar të raportoj në MAPL-në për rrjedhat e realizimit të projektit sipas dinamikës së punimeve deri në përfundim të projektit.

Neni 5

Dokumentacioni i nevojshëm për pagesë nga Komuna

1. Komuna obligohet që për t'i realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera të komplettoj dokumentacionin si në vijim:
 - 1.1. Kopjen e Kontratës të nënshkruar së bashku me Kushtet e përgjithshme, të veçanta dhe ofertën financiare e cila duhet të jetë identike me origjinalin e vërtetuar nga menaxheri i prokurimit të komunës;
 - 1.2. Vendimin për caktimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionin e pranimit nga ana e Komunës, në rast se nuk është e definuar me kushtet e veçanta në kontratë;
 - 1.3. Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimit mbi punët/furnizimet e kryera të aprovuara (origjinali);
 - 1.4. Faturën nga operatori ekonomik dhe situacionin e aprovuar (origjinali);
 - 1.5. Sigurimin e ekzekutimit, garanacionin e kualitetit me pranim teknik sipas kushteve të kontratës;
 - 1.6. Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është i regjistruar në SMIFK-Departamenti i Thesarit-Ministria e Financave).

Neni 6
Pronësia e projektit

1. Deri në momentin e pranimin të pasurisë jo financiare organizatat buxhetore financuese (MAPL) do të regjistrojnë transaksionin në kategorinë e investimeve në vijim.
2. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, pagesa e fundit me pranim teknik në rastet: kur MAPL i kryen të gjitha Pagesat e situacioneve dhe në rastin që komuna e kryen pagesën- situacionin e fundit me pranim teknik, organizata buxhetore financuese në këtë rast MAPL-ja do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim.
3. Organizata buxhetore pranuese, në këtë rast Komuna, pasurinë jo financiare të pranuar nga MAPL-ja do ta regjistroj në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj.

Neni 7
Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit

1. Me pëlqimin paraprak të Ministres të MAPL-së, dhe Kryetarit të Komunës marrëveshja mund të ndryshohet, modifikohet dhe plotësohet.
2. MAPL-ja mbanë të drejtën e ndërprerjes së Marrëveshjes në rast se konstaton se Komuna nuk i përmbush obligimet e veta të dala nga kjo Marrëveshje.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Palët janë pajtuar që mosmarrëveshjet të zgjidhen me mirëkuptim.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga Ministri i MAPL-së dhe Kryetari i Komunës.

Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në dy (2) kopje origjinale, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.

Adrijana Hodžić
Ministre e MAPL-së



Bali Muharemaj,
Kryetari i Komunës së Suharekës

